



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.07.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Elezi– nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, date 28.07.2008 "Për taksat kombëtare".
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Marrin pjesë:

Edlira Hyseni, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Nikolin Staka, Ervin Bushati, Artur Roshi, Vullnet Sinaj, Dritan Bici, Ardit Konomi, Korab Lita, Arben Elezi, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Arben Ahmetaj, Evis Kushi, Artemis Dralo (Malo), Senida Mesi, Reme Lala, dhe Anastas Angjeli.

I ftuar:

Ilir Beqaj – deputeti nismëtar

HAPET MBLEDHJA

Arben Elezi – Fjalën e ka zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Të nderuar kolegë,

Faleminderit që më dhatë mundësinë të prezantoj nismën që kam depozituar në Kuvend disa javë më parë!

Në fakt, shtysa ka ardhur nga komunikimi që kemi pasur në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese në vijim të punës sonë normale me sipërmarrje dhe sipërmarrës të ndryshëm, si dhe përfaqësues të organizimeve të tyre lidhur me problematikat që ata filluan të hasnin nga fundi i janarit 2019 e në vijim me fillimin e zbatimit konkret të paketës fiskale të miratuar në Kuvendin e Shqipërisë në dhjetor të vitit 2018, kryesisht për pjesën e ndryshimit të regjimit të taksimit të plastikës. Në fakt, në muajin nëntor, kur diskutohej paketa fiskale, ne kemi pasur edhe në komisionin tonë diskutime të shumta dhe të gjata deri në momentin e miratimit të nismës, madje në atë kohë, ne, si komision patëm bërë edhe një propozim, por që nuk pati mbështetjen e shumicën në seancë. Megjithatë gjatë zbatimit u vu re që praktikisht po ndodhnin disa rritje të kostove të produkteve të ndryshme, të cilat nuk ishin qëllimi i nismës në nëntor të vitit 2018. Konkretisht bëhet fjalë jo për produktet plastike, të cilat, pas përdorimit, kalojnë drejtpërdrejt në mjedis, por për produkte plastike apo lëndë të para, të cilat trupëzohen në një objekt apo godinë, jetëgjatësia e të cilave vazhdon me dhjetëra vite.

Për ilustrim: tubat e shkarkimit të ujërave të përdorura në një pallat janë pjesë e pallatit dhe rrinë aty me vite. Një dritare plastike që vendoset në një pallat është pjesë e vetë pallatit dhe rri aty me vite, ose tubat plastikë që përdoren në bujqësi, apo lënda e parë, që përdoret për prodhimin e bojës plastike. Para shumë vitesh ne e importonim bojën, më vonë filluam ta prodhonim në Shqipëri, por ka ende një lëndë të parë që hyn në grupet e plastikës, e cila në janar dhe në vijim filloi të taksohej. Çfarë solli kjo gjë? Solli atë që, nëse deri vjet tubat plastikë kushtonin 180 lekë për kilogram, sot kushtojnë 250 lekë për kilogram dhe vetëm vendosja e taksës së re e rriti koston e tyre me 13,8%. Nëse më përpara bojërat plastike kushtonin 136 lekë për kilogram, me taksën e re kushtojnë 161 lekë për kilogram. Pra, vendosja e taksës e rriti koston e bojës 18%. Sfungjeri që përdoret në mobilie, nëse më parë kushtonte 185 lekë për kilogram, sot kushton 210 lekë për kilogram, apo polisteroli që përdoret në shtresat e ndërtimit nëpër pallate, nëse kushtonte 70 lekë për kilogram më parë, sot kushton 95 lekë dhe kjo e rriti koston me 35,7%. Pra ka edhe elemente të ndryshme, prandaj unë kam paraqitur propozimin që keni përpara. Sigurisht që kam bërë një vlerësim të

kostos vjetore në buxhet të asaj që është propozuar këtu dhe në një vit të plotë financiar do të kemi një mungesë rreth 200-225 milionë lekë në të hyrat tatimore.

Këto ishin ato që doja të propozoja. Jam i gatshëm t'u përgjigjem pyetjeve tuaja, nëse do të keni.

Arben Elezi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Antoneta.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti drejtues i komisionit!

Projektligji që po diskutojmë sot është propozim i kolegut Ilir Beqaj dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financës e shqyrton atë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit. Taksa mbi ambalazhet plastike është vendosur për shkak të ndotjes që këto produkte sjellin në mjedis dhe të politikave për reduktimin e saj. Deri në fund të vitit 2018 taksa për ambalazhet plastike të importuara ishte një 100 lekë dhe zbatohej si në import, ashtu dhe në prodhimin vendas. Taksa për ambalazhet plastike të prodhuara nga industria vendase e riciklimit të mbetjeve plastike ishte 1 lekë për kilogram. Gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji u evidentuan disa problematika si: diskriminimi i biznesit në importet e ambalazheve plastike për shkak të diferencës së madhe në nivelin e taksës mbi ambalazhet plastike, që prodhohen në vend, evazioni fiskal në mbledhjen e taksës së ambalazheve plastike të prodhuara në vend, i cili ndodhi për arsye se prodhuesit vendas deklarorin sasinë minimale të prodhimit të ambalazheve plastike, që kishte taksë 100 lekë për kilogram dhe rrisnin deklarin me lëndë të parë jo ambalazh, të cilat, nuk ngarkoheshin në këtë taksë.

Kjo solli reduktimin e të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë. Paketa fiskale, e cila u miratua në vitin 2018 dhe hyri në fuqi në janar të vitit 2019, synoi të zgjidhte problematikat e mësipërme, ndaj solli dhe ndryshimet si më poshtë:

U vendos taksë jo vetëm për ambalazhet plastike, por edhe për materialet plastike të importit, si dhe lëndë të para për prodhimin e ambalazhit plastik në vend në formë granulati. Ky ndryshim lidhet me faktin se si ambalazhet plastike dhe materialet plastike, ndikonin njëllor në ndotjen e mjedisit. U ndryshua niveli i taksës, taksa për ambalazhet plastike dhe materialet plastike të importuara u reduktua nga 100 lekë në 35 lekë për kilogram, taksa për lëndën e parë të importuar për prodhimin brenda vendit të produkteve plastike u caktua 25 lekë për kilogram dhe kjo taksë u vendos mbi lëndën e parë dhe jo mbi produktin e gatshëm për arsye të lehtësisë të mbledhjes së saj në momentin e importit krahasuar me momentet e shitjes së produktit të gatshëm të prodhuar në vend. Taksa e ambalazheve të qelqit si të importit ashtu dhe të vendit, u caktua 5 lekë për kilogram. Ndryshimi i nivelit të taksës mes materialeve plastike të importit dhe atyre të prodhuara në vend u argumentua me faktin se

lënda e parë pëson firo gjatë procesit teknologjik të shndërrimit të produktit të gatshëm. Synimet e këtyre ndryshimeve ishin: reduktimi i nivelit të taksës për produktet plastike, heqja e diferencimit në nivelin e taksës për ambalazhet plastike të importit, krahasuar me ato të prodhuara në vend dhe vendosja e një konkurrence të drejtë në treg dhe zgjerimi i bazës së taksueshme në industrinë vendase të plastikës nëpërmjet politikave për eliminimin dhe shmangien nga pagimi i saj.

Projektligji synon të vijojë dhe thellojë masat lehtësuese fiskale të miratuara në paketën fiskale të vitit 2019 në fushën e materialeve dhe të ambalazheve plastike. Konkretisht, shtesat dhe ndryshimet e propozuara në ligjin ekzistues synojnë lehtësimin e barrës së taksave të lëndëve të para për prodhimin e artikujve të plastikës të prodhuar në vend. Taksa mbi lëndët e para primare, të cilat importohen për prodhimin e artikujve të plastikës në vend, parashikohet të reduktohen nga 25 lekë për kilogram në 10 lekë për kilogram. Synohet gjithashtu rimbursimi i taksës jo vetëm për ambalazhet që eksportohen, por edhe për çdo artikull tjetër plastik që eksportohet si lëndë të para dhe materialet e artikujve prej plastike, përjashtimi dhe pagimi e taksës së një sërë lëndësh të para dhe artikuj plastikë, që përdoren në proceset teknologjike për prodhimin e mallrave jo plastike, si dhe i lëndëve të para, që përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë, të industrisë së prodhimit të mobilie dhe sallameve.

Në fakt, efektet financiare, sipas relacionit të paraqitur, ulja e taksës për lëndët e para primare, shoqërohen me një efekt në buxhetin e shtetit nga 200 deri në 225 milionë lekë në vit, në kushtet kur ky projektligj do të hyjë në fuqi në mes të vitit, kështu që kjo taksë përgjysmohet.

Unë i ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë propozimin e kolegut Beqaj për këtë projektligj!

Faleminderit!

Arben Elezi – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka zoti Roshi.

Artur Roshi – Kam një pyetje të thjeshtë.

Zoti Beqaj, cila është referenca juaj që e keni bërë 10 lekë uljen dhe jo 5 lekë? Cila është logjika? Keni kërkuar të ulet taksa nga 25 lekë në 10 lekë për kilogram. Pse nuk është 5 lekë?

Ilir Beqaj – Sepse është pasur parasysh ruajtja e një raporti të caktuar mes ngarkesës së taksimit të produktit të gatshëm në import dhe ngarkesës së lëndës së parë, sepse mund të ishte edhe zero, por për sa kohë ka në import, ne kemi marrë disa angazhime dhe nuk mund të krijojmë barriera për importin e produktit të gatshëm në krahasim me zhvillimin e prodhimit

vendas. Këtu e preku pak edhe kolegja, që është marrë parasysh fakti që, nëse produkti i gatshëm, kur vjen, vihet më shpejt në qarkullim, lënda e parë ka firo sipas kartës teknologjike të linjës së prodhimit, e dyta, deri në momentin që del në treg, përveç kohës së prodhimit, parapagimi në doganë ka edhe një kosto të parasë në kohë. Këto kanë qenë vlerësimet e mia që arrita të bëj këtë propozim.

Ismet Beqiraj – Zoti Beqaj, kam një pyetje, më shumë për sqarim. Te neni 2, ku bëhet një shtesë për nenin 9, germa “f” thuhet: “...lëndë e parë në formë primare me përmbajtje proteinike të forta, apo materiale celulozike, sipas kapitullit 39 të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve”, po për ambalazhet e jashtme, për veshjen e mobilieve gjatë transportit, paleta të produkteve të ndryshme, shisheve etj. Relatorja e tha por unë nuk e shoh në projektligj. Është një konsum shumë i madh.

Ilir Beqaj – Faleminderit për pyetjen!

Në projekt unë jam përqendruar te produktet që kanë jetëgjatësi, ajo që thoni ju është pjesa e ambalazhit dhe qëllimi im nuk ka qenë të merrem më ambalazhin, sepse ne kemi pasur një regjim taksimi të caktuar për ambalazhin deri vitin e kaluar dhe më pas kaluam në një regjim të taksimit të plastikës në mënyrë uniforme (ambalazh ose jo), por në zbatim lindën probleme te produktet e gatshme me përmbajtje plastike, sepse vetë ambalazhin e ulëm nga 100 lekë në 35 deri në 25 lekë, pra ia kemi ulur me 3-4 herë taksën që vjet. Nuk jam i prirur të mbështes ulje të mëtejshme të ambalazhit, i cili pas transportit, që rrethon një paletë, shkon drejt ndotjes në mjedis.

Ismet Beqiraj – Në vazhdim të pyetjes së parë, doja të dija a keni shqetësime nga prodhuesit e këtyre artikujve, që punojnë kryesisht me lëndë të parë importi sipas standardeve cilësore të BE-së? A i keni marrë në konsideratë shqetësimet e tyre?

Ilir Beqaj – Unë u shpreha që në fillim të prezantimit që shqetësimet e tyre më çuan te ky projektligj.

Ismet Beqiraj – Nuk është pasqyruar.

Ilir Beqaj – Janë pasqyruar shqetësimet e prodhuesve të ambalazheve, të cilëve ua kemi ulur vjet 4 herë taksën dhe unë nuk propozoj t’ua ulim akoma.

Ismet Beqiraj – Ata marrin lëndë të parë nga jashtë sipas standardeve të BE-së, e fusin këtu, e përpunojnë....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht që ambalazh prodhojnë, por ata janë përjashtuar nga kjo.

Ilir Beqaj – Ambalazh prodhonin vjet, ambalazh prodhojnë edhe sivjet, sipas standardeve. Vjet i taksonim 100 lekë, sivjet i taksojmë 35-25 lekë. Pra, atyre që prodhojnë ambalazh sipas standardeve ua ulëm taksimin. Unë, në propozimin tim, nuk merrem me

vazhdimin e uljes së taksimit të ambalazhit, sepse pas 6 muajsh që prodhohet shkon në mjedis, por jam marrë me dritaren pvc, që, po u vendos në godinë, rri aty 20 vjet. Për më tepër, ne kemi një ligj të eficiencës së energjisë, të cilën e mbështesim, dhe nuk mund të krijojmë barriera që kjo eficiencë të mos jetë e zbatueshme.

Arben Elezi – Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Zoti drejtues i komisionit, unë e falënderoj zotin Beqaj për propozimin, por gjykoj se për shkak se kjo iniciativë ka efekte financiare në buxhet ne, si komision, duhet t'i drejtohem Ministrisë të Financave, e cila do të shprehet brenda 30 ditësh për këtë projektligj dhe do ta sjellë përsëri në komision, që ta shqyrtojmë dhe ta miratojmë.

Faleminderit!

Arben Elezi – Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Ulja e nivelit të taksave për lëndët e para primare nga 25 lekë për kilogram në 10 lekë për kilogram do të thotë se qeveria pranon gabimin që ka bërë kur ka vendosur taksën 25 lekë për kilogram. Kjo tregon se ne nuk duhet të jemi të shqetësuar sot vetëm për uljen e taksës për këta prodhues, apo importues, por duhet të jemi të shqetësuar edhe për paketën, që duhet të shoqërojë këtë projektligj në lidhje me dëmet që i kemi sjellë biznesit gjatë kohës, që ka funksionuar taksa 25 lekë për kilogram. Pra, në këtë moment ne do ta quanim që kjo ishte e plotë. Kush mban përgjegjësi për dëmet që i ka sjellë biznesit? A duhet të jetë qeveria? Unë them se po dhe kjo duhet të vijë e plotë bashkë me paketën e dëmshpërblimeve, që i ka sjellë biznesit. Ekonomia nuk është vetëm e qeverisë, sepse, në radhë të parë, është e atyre që bëjnë biznes, kurse qeveria është ajo që duhet të harmonizojë problemet që ka në tërësi ekonomia dhe nuk ka tagrin të ulë apo të ngrejë taksat sa herë që i bindet apo jo logjikës ose emocionit. Në këtë rast ka treguar se i bindet emocionit dhe jo logjikës.

Ju faleminderit!

Ilir Beqaj – Besoj se është e qartë këtu që unë e kam firmosur si deputet, nuk jam këtu si përfaqësues i qeverisë. Qeveria do të shprehet vetë, se ende nuk është shprehur. Shqetësimin e bizneseve ndaj problemit të zbatimit të projektligj më tej se qëllimi i paketës fiskale, jam përpjekur ta reflektoj në këtë projekt.

Arben Elezi – Fjalën e ka zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj të bëjmë më shumë ekonomi sesa politikë këtu, sepse pavarësisht si është problemi, korrigjimi i diçkaje të bërë gabim do të thotë se po bëjmë një gjë të drejtë për ekonominë dhe për prodhuesit vendas. Doja të thosha që, edhe pse ka reflektim për këtë, ka

30 vjet që ekonomia e këtij vendi është çuar në atë pikë ku raporti i eksporteve me importet është ai që ne e dimë shumë mirë, pra që bankat detyrohen të nxjerrin lekë *cash* nga ky vend.

Të gjitha këto, i nderuar zotëri, vijnë nga mungesa e prodhimit dhe eksportit në ekonominë tonë, prandaj këto gabime nuk janë bërë këto vite. Nëse ka ndodhur për 3 muaj dhe bëhet një korrigjim apo reflektim kjo është pozitive. Qëllimi nuk ka qenë për të dëmtuar prodhuesit vendas, sepse me ta janë bërë disa takime dhe konsultime dhe ato para që janë grumbulluar nga këto taksa kanë kaluar në buxhetin e shtetit, nuk kanë shkuar në vend tjetër. Ndryshimet që propozon zoti Beqaj është mirë të mos i diskutojmë për asnjë moment, sepse u vijnë vërtet në ndihmë ekonomisë dhe prodhuesve vendas. Unë kam qenë kundër ngritjes së asaj takse që atëherë dhe më vjen mirë që kolegu i ka sjellë këto ndryshime. T'i lëmë pak të qetë shqiptarët, se mjaft politikë po bën opozita rrugore, e cila i ka lënë turizmin dhe pjesën e ekonomisë që merret me turizëm batall pa punë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos filloni edhe ju të bëni të njëjtën gjë, por tregoni opozitë konstruktive dhe kuptojeni drejtë, ashtu siç e kemi kuptuar ne!

Arben Elezi – Zoti Sinaj, përqendrohuni te rendi i ditës, lëreni opozitën!

Vullnet Sinaj – E para, unë nuk ta ndërpreva fjalën kur fole, të dëgjova me vëmendje dhe tani po them mendimin tim. Ulja e kësaj takse për prodhimin shqiptar është shumë e rëndësishme për ekonominë e këtij vendi dhe ju propozoj të mos e zgjasim, por ta kalojmë menjëherë në votim dhe ta miratojmë.

Faleminderit!

Arben Elezi – Po, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Së pari, unë falënderoj zotin Beqaj për nismën që ka ndërmarrë, e cila vjen në vazhden e konsultimeve me prodhuesit e këtij sektori, të cilët kanë qenë në diskutime edhe për pjesën e paketës fiskale për këtë taksë pra ka pasur shumë debate. Kështu që ne kemi reflektuar për një sërë kërkesash të biznesit, që janë ndryshuar gjatë mbledhjeve të këtij komisioni dhe ndryshimet kanë kaluar në seancë. Besoj se reflektimi ynë i herëpashershëm në mbështetje të kërkesave që ka biznesi për të ndihmuar, lehtësuar, zhvilluar dhe nxitur punësimin në vend, duhet të jetë në fokusin tonë të përditshëm, ndaj reflektimi në këto momente është ai i duhuri. I shpërblejmë, apo jo për çfarë kanë paguar, unë besoj se askush nga biznesi nuk kërkon shpërblim, por mbështetje nëpërmjet uljes së taksimit, nxitjes së krijimit të të gjitha kushteve për të bërë të mundur që këto biznese të jenë punëdhënëse dhe kontributore të mëdha të buxhetit të shtetit. Për këtë arsye ne duhet të vazhdojmë ta votojmë.

Më pas, në seancë, ne mund të kemi nga Ministria e Financave vlerësimin përkatës për ndikimin që do të ketë në buxhet kjo nismë. Mendoj se edhe me paketën e re fiskale, që do të vijë në sesionin tjetër, ndoshta do të kemi mundësinë të shohim se si mund të ndihmojmë dhe nxisim edhe sektorët e tjerë të biznesit, për të bërë të mundur që ekonomia të zhvillohet më shumë.

Jam e bindur së po të kishim bërë një analizë të plotë të ndryshimeve që ka sjellë paketa fiskale në biznes do të shihnim që janë reflektuar një sërë kërkesash të kahershme të biznesit, ndaj ju ftoj ta votojmë.

Arben Elezi – A ka më diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Ervin Bushati – Faleminderit, zoti drejtues i komisioni!

Në fakt, nga bashkëbisedimi me relatorët dhe me komisionin përkatës duhet të sjell në vëmendje që produkti pvc, është shumë i rëndësishëm në industrinë e ndërtimit dhe një nga teknologjitë më të reja, që vjen nga Gjermania e përhapet në të gjithë Europën. Duke e përafruar atë me legjislacionin ekzistues shqiptar që kemi për ruajtjen e eficiencës energjetike, dua të përfshihen në germën “e” të nenit 2 edhe profilet pcv, të cilat nuk janë mbeturina, por profile në ndërtim për dritare dhe veranda. Ato kanë një periudhë të gjatë përdorimi, mbi 30 vjet, dhe janë të inkorporuar në vlerën e ndërtesës, pra të produktit të palëvizshëm. Për këtë arsye propozoj që produktet e pvc-së të përjashtohen nga pagimi i taksave kombëtare dhe germa “e” e nenit 2 të riformatohet kështu: “Lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit *IPS Expanded Polysteren*, importimin e paneleve, pllakave të polisterolit *XPS Extruded Polysteren*, si dhe profilet pvc për prodhimin e dymave dhe dritareve sipas kapitullit 39 të NKM-së, artikuj, që përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës energjetike”.

Kërkoj nga kolegët që ta mbështesin edhe këtë ndryshim në nenin 2, germa “e”!

Faleminderit!

Arben Elezi – Atëherë shtohet edhe ndryshimi që bëri zoti Bushati.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Ju faleminderit!

Për çështjen e dytë, pra për korporatën e investimeve, është rënë dakord edhe me opozitën që të ngrihet një grup pune që ta hartojmë nga shtatori me ekspertët përkatës. Ta shohim dhe të mundohemi të bëjmë më të mirën për qytetarët shqiptarë.

Këtu mbyllet mbledhja e komisionit.

Ju uroj ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti